



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:064733

Datë: 20.09.2024

Numri i dokumentit: 06187989

KA.nr. 634/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “Avex Health” ShPK me NUI 81076712 dhe me seli në Zonën Industriale në Fushë Kosovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokate Erblina Krasniqi me seli në rrugën “Radovan Zogoviq” nr. 95 në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë me seli në Prishtinë, objekti i kontesti anulimi i aktit administrativ, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 03.09.2024, në të cilën nuk mori pjesë asnjëra palë, më 10 shtator 2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit “Avex Health” ShPK me NUI 81076712, kundër të paditurit Ministria e Shëndetësisë, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit 10/K-014-21 me numër të protokollit 05-1022/2 të datës 25.02.2021 i të paditurit dhe lënda të kthehet në rishqyrtim te Kryeinspektori Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve

1. Paditësi përmes padisë së datës 07.04.2021 kundër të Paditurit e ka iniciuar konfliktin administrativ, ndërsa më datë 26.04.2021 ka bërë rregullimin e padisë, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit me nr. 10/K-014-21 me numër të protokollit. 05-1022/2 të datës 25.02.2021 dhe lënda të kthehet në rishqyrtim në rishqyrtim te Kryeinspektori Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë.
2. Ai në padi ka pretenduar se, Inspektorati Farmaceutik ka kryer inspektim pranë kompanisë “Elioni” me seli në Kaqanik dhe gjatë inspektimit ka gjatuar disa fatura të cilat janë lëshuar nga ai për furnizim me produkte mjekësore, ndërsa më datë 08.04.2020 Inspektorati Farmaceutik ka kryes inspektimin pranë kompanisë Avex

Health ShPK në praninë e farmacistit përgjegjës, e ka njoftuar atë se faturat sipas nr. 385/20 të datës 11.01.2020, 959/20 e datës 25.01.2020, 1258/20 e datës 01.02.2020, 1968/2020 e datë 15.02.2020, 4354/2020 e datës 17.03.2020, 4707/2020 e datës 21-3/2-2 dhe 5462/2020 e datës 28.03.2020, të lëshuara për shoqërinë tregtare “Elioni” janë lëshuar në kundërshtim me ligjin, sepse subjekti juridik “Elioni” nuk ka pasur licencë valide. Sipas tij, farmacisti i kompanisë ka theksuar se nuk kanë qenë në dijeni që e njëjta nuk ka ripërtërirë licencën e saj dhe një informatë të tillë paditësja nuk ka pasur si ta kuptoj, meqë të dhënat për kompanitë e licencuara nuk janë ripërtërirë nga Agjencia Kosovare për Produkt dhe Pajisje Medicinale. Sipas tij, ripërtërija e listës në vitin 2020 është bërë tek në muajin prill, ndërsa fatura janë lëshuar për muajt shkurt dhe mars të atij viti, data këto në të cilat të publikuara kanë qenë lista nga vitit i kaluar, sipas të cilës “Elioni” ka figuruar si barnatore e licencuar dhe se përditësimi i të dhënave nga e Paditura në web faqe nuk është realizuar me kohë.

3. Përfundimisht ka deklaruar se pas inspektimit e Paditura ka nxjerr vendim nr.10/J-007-20 të marrë më datë 20.05.2020 duke shqiptuar gjobën në vlerë prej 1,000.00€ pa bazë ligjore, për faktin se vet ajo nuk e ka informuar më e kohë Paditësin, rrjedhimisht duke mos e bërë përditësimin e listës në baza mujore siç përcaktohet në nenin 13 par. 10 i Ligjit Nr, 04/L-190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale, vendimin e cila e ka mbështetur në nenin 13 par.9 nënpara. 9.1 të të njëjti ligj duke e ndëshkuar pa të drejtë paditësin. Në seancën e shqyrtimit kryesor nuk mori pjesë fare, ndonëse ishte ftuar në mënyrë të rregullt përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar.
4. I padituri në përgjigje e tij në padi ka deklaruar se vendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave ligjore në fuqi dhe ajo në të cilin pretendon pala nuk qëndron se ky vendim është marrë me shkelje ligjore, për arsye se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë. Në seancën e shqyrtimit kryesor nuk mori pjesë fare, ndonëse ishte ftuar në mënyrë të rregullt.

II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

5. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e prova. Në këtë drejtim, në seancën për shqyrtimin kryesor u administruan provat si në vijim: vendimi nr.10/J-007-20 i datës 06.05.2020 i të paditurit; Vendimi nr. 10/K-014-21 i datës 25.02.2021 i të paditurit;

Raporti i inspektimit për qarkulluesin farmaceutik me shumicë për produkte dhe pajisje medicinale me numër të protokollit 05-2399 i datës 06.05.2020 i të paditurit për paditësin; Procesverbali mbi inspektimin e kryer me numër rendor 00679 i datës 28.04.2020 i të paditurit në emër të paditësit; Fatura me numër 385/20 e datës 11.01.2020 lëshuar nga paditësi; Fatura me numër 959/20 e datës 25.01.2020 lëshuar nga paditësi; Fatura me numër 1258/20 e datës 01.02.2020 lëshuar nga paditësi; Fatura me numër 1968/20 e datës 15.02.2020 lëshuar nga paditësi; Fatura me numër 4354/20 e datës 17.03.2020 lëshuar nga paditësi; Fatura me numër 4707/20 e datës 21.03.2020 lëshuar nga paditësi; Fatura me numër 5462/20 e datës 28.03.2020 lëshuar nga paditësi.

6. Gjykata pas analizimit të provat të cekura më lartë në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe duke i zbatuar rregullat e të provuarit nga neni 322 i LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-së e konstatoi gjendjen faktike të përshkruar më poshtë.
7. Inspektorati Farmaceutik më 14.04.2020 ka kryer inspektimin te një depo e shoqërisë tregtare “Elioni” dhe ka konstatuar se ajo ka ofruar shërbim farmaceutik me pakicë në mënyrë të pa autorizuar, pa licencë valide të veprimtarisë që nga muaji prill 2019. Gjithashtu, Inspektorati Farmaceutik gjatë atij inspektimit i ka gjetur faturat me numër 385/20 e datës 11.01.2020; me numër 959/20 e datës 25.01.2020; me numër 1258/20 e datës 01.02.2020, me numër 1968/20 e datës 15.02.2020, me numër 4354/20 e datës 17.03.2020; me numër 4707/20 e datës 21.03.2020; me numër 5462/20 e datës 28.03.2020, të lëshuara nga Paditësi. Këto fakte gjykata i vërtetoi përmes procesverbalit me nr. 00679 të datës 28.04.2020 dhe faturave të sipërshënuara.
8. Më datë 28.04.2020 Inspektorati Farmaceutik ka kryer inspektim te Paditësit, të cilët e ka njoftuar se pas inspektimit të datës 14.04.2020 te depoja “Elioni”. Farmacisti përgjegjës e kishte konfirmuar se e kanë furnizuar shoqërinë tregtare “Elioni” sipas faturave të cekura më lartë. Gjithashtu, farmacisti përgjegjës kishte shënuar vërejtjen se ato lëshime janë bërë për shkak të mos përditësimit me kohë të listave të barnatoreve të licencuara. Inspektorati Farmaceutik gjatë inspektimit kishte urdhëruar që shpërndarja e produkteve dhe pajisjeve medicinale të bëhet vetëm për barnatoret e licencuara. Këta fakte gjykata i vetëtoi përmes procesverbalit me nr. 00679 të datës 28.04.2020.
9. Më datë 06.05.2020 Inspektorati Farmaceutik e ka nxjerr vendim me nr. 10/J-007-20 përmes të cilit Paditësin e ka ndëshkuar me gjobë në lartësi prej 1000€ për shkak të

shpërndarjes së e produkteve dhe pajisjeve medicinale te barnatoret e palicencuara. Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes vendimit të sipërshtuar.

10. Padiësi më 12.02.2021 ka parashtruar ankesë ndaj vendimit të shkallës së parë, ndërsa i Padiësit si organ i shkallës së dytë përmes Kryeinspektorit Shëndetësor më datë 25.02.2021 përmes vendimit me nr. 10/K-014-21 e ka hedhur poshtë ankesën e Padiësit si të pa afatshme dhe e ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë. I Padiuri vendimin e ka arsyetuar se Padiësi ka paraqitur ankesë më 12.02.2021, ndërsa vendimin e shkallës së parë e ka pranuar më datë 13.01.2021, kurse afati për ankesë ka qenë 8 ditë. Këto fakte gjykata i vërtetoi përmes vendimit të sapo cekur.
11. Përveç kësaj, gjykata erdhi përfundim se Padiësi vendimin e shkallës së parë, e ka pranuar më 13.01.2021, siç ka konstatuar i Padiuri në vendimin e goditur, meqenëse Padiësi nuk ka paraqitur asnjë provë, nga e cila do të provohej se është i pasaktë konstatimi i të Padiuri për datën e pranimit të vendimit të shkallës së parë. Gjykata rikujton se barrën e provës e ka Padiësi, gjegjësisht ai e ka barrën që të provoj se ankesa e tij është dorëzuar me kohë. Gjithashtu, gjykata konstaton se Padiësi tek më 12.01.2021 kishte paraqitur ankesë, që nënkupton se ai ankesën e ka ushtruar pasi kishte kaluar afati prej tetë ditëve.

III. Vlerësimi meritor i rastit

12. Gjykata pas i mori parasysh të gjitha pretendimet e ndërëgjyqësve, gjendjen faktike të konstatuar, si dhe pas analizimit të dispozitave juridike të shqyrtuara më poshtë, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e Padiësit është e pabazuar në ligj, rrjedhimisht kërkesëpadia e Padiësit duhet të refuzohet
13. Në rend të parë, gjykata gjen se procedura administrative që i ka paraprirë aktit administrativ të goditur është zbatuar në përputhje me LPPA-në. Gjithashtu, gjykata vë në pah se vendimi i goditur është i hartuar sipas nenit 47, 48 dhe 134 të LPPA-së. Gjykata po ashtu vlerëson se, akti administrativ i shkallës së parë ishte lëshuar me informacion të mjaftueshme në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike).
14. Në lidhje me këtë, gjykata vlerëson se në vendimin e goditur i Padiuri i ka paraqitur të gjitha të dhënat relevante lidhur me afatshmërinë e mjetit juridik, konkretisht është saktësuar data e dorëzimit të aktit administrativ dhe data e paraqitjes së ankesës, në

bazë të cilave gjykata mund ta vlerësoj afatshmërinë e ankesës ndaj aktit administrativ të shkallës së parë.

15. Përveç kësaj, gjykata gjen se i Padituri i ka konstatuar të gjitha faktet relevante lidhur me rastin, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë në kuptim të gjendjes faktike lidhur me shkeljet e konstatuara. Në këtë drejtim, gjykata vlerëson se vendimin e kundërshtuar i Padituri e ka mbështetur në faktin e afatshmërisë së ankesës së Paditësit. Siç është cekur më lartë, kjo gjykatë ka ardhur në përfundimin se ankesa e Paditësi ka qenë ushtruar jashtë afatit.
16. Situata e lartcekur rregullohet me nenin 129 para. nënpara. 3 të LPPA-së, sipas të cilit *“Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji”*, lidhur me nenin 132 para. 2 të LPPA-së, sipas të cilit *“2. Organi epror, me akt administrativ, do të refuzojë ankesën nëse ankesa është e papranueshme, apo është e pabazuar, në pikëpamjen e ligjshmërisë apo përshtatshmërisë”*. Nga këto dispozita rrjedh se ankesa mund të shqyrtohet vetëm nëse është ushtruar brenda afatit, ndërsa kur ajo është jashtë afatit, atëherë ajo është e papranueshme.
17. Gjykata i shqyrtoi edhe pretendimet e Paditësit lidhur me gjendjen faktike, por erdhi në përfundim se ato nuk janë relevante lidhur me rastin konkret. Gjykata rikujton se ankesa e Paditësit ishte hedhur poshtë si e paafatshme, rrjedhimisht përderisa nuk konstatohet se ankesa e Paditësit ka qenë e afatshme, atëherë çështjet e ligjshmërisë së aktit administrative në kuptim të gjendjes faktike ose të së drejtës material administrative nuk mund të shqyrtohen.
18. Prandaj, meqenëse procedura që i ka paraprirë nxjerrjes së aktit administrativ të goditur është zbatuar në tërësi sipas rregullave të procedurës administrative, duke qenë se akti administrativ i goditur është dhënë në përputhje me nenet 47, 48 dhe 134 të LPPA-së, duke marrë parasysh se i Padituri e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike, siç është sqaruar edhe në pjesën e gjendjes faktike në këtë arsyetim, gjykata vjen në përfundim se nuk është plotësuar asnjë kusht ligjore nga neni 52 i LPPA ose neni 16 i LKA për anulimin e aktit administrativ të goditur, rrjedhimisht e refuzoi kërkesëpadinë e Paditësit për anulimin e aktit administrativ të goditur.

19. Për arsyet e cekura më lartë, gjykata duke u bazuar në nenet 13, para. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës
Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative
KA.nr.634/22

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.